

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË "ABEG" Sh.p.k.**

Sot, me datë 27/10/2020,

**Z. Besnik Myftari**, shtetas shqiptar, atësia Aziz, lindur më 14/04/1968, në Tiranë, banues në adresën: Njësia Administrative Nr. 5, Rruga "Ismail Qemali", Godina nr. 18, Ap. 10, Tiranë, mbajtës i dokumentit Pashaportë me Nr. BR6888468 dhe nr. personal. G80414170N, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "ABEG" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1. EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "ABEG" Sh.p.k.

**NENI 2. SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njësia Administrative Nr. 10, Rruga "Islam Alla", Pall. Nr. 1/5, Tiranë.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3. KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

**NENI 4. OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

Media audiovizuale dhe e shkruar, libra, Cd, muzikë, revista, gazeta etj;

a. Shitje dhe blerje e kontentit televiziv; shitje dhe blerje e kapacitetit të internetit, produksione televizive me zë dhe figurë, evente radiotevizive live; transmetime dhe ritransmetime audio, video dhe data; krijimi i platformave audio - video ofruese, kanaleve televizive dhe transmetimi nëpërmjet satelitit, internetit, sistemeve të frekuencave tokësore, ajrore dhe kabllore, pajisje elektronike, audio - vizive dhe informatike; ndërtimi dhe përpunimi i qendrave të të dhënave.

b. Shoqëria do të kryejë veprimtari edhe në fushën e ofrimit të shërbimeve të ndryshme online. Në fushën publicitare do të ofrojë shërbime të reklamimit të produkteve dhe shërbimeve nga individë apo shoqëri tregtare, shërbime në fushën e komunikimeve elektronike, dixhitale, grafike, të medias etj.

c. Shoqëria mund të marrë pjesë me cilësinë e ortakut apo aksionerit në shoqëri të tjera tregtare me objekt veprimtarie të njëjtë apo të ndryshëm nga i saj.

d. Furnizimi i çdo lloji shërbimi informatik, përfshirë këtu të gjitha llojet e specializimit, në varësi të reparteve përkatëse si: veprimtari koordinimi informatik, informacioni dhe telekomunikacioni që synon përmirësimin e prodhimtarisë dhe aftësisë së ndërmarrjeve;

Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdo lloji veprimtarie tjetër të lejuar me ligj në përputhje me rregullat në fuqi.



Veprimtari në fushën e mediave televizive. Ai përfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kabllove, përsëritësve, sateliteve apo me çdo formë tjetër transmetimi audioviziv. Transmetime audiovizive numerike me mbulim tokësor kombëtar, platformë numerike, prodhues dhe transmetues i eventeve televizive audiovizive, distribucion i të drejtave televizive të kanaleve TV dhe programeve në çdo formë të njohur transmetimi brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## **NENI 5. KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakut themelues në vlerën 1.000.000 (një milion) Lekë dhe përbëhet nga një 1 kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Besnik Myftari**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1.000.000 (një milion) Lekë dhe 1.000.000 (një milion) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## **NENI 6. ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z. Besnik Myftari**, shtetas shqiptar, lindur më 14/04/1968, në Tiranë, mbajtës i dokumentit Pashaportë me Nr. BR6888468 dhe nr. personal. G80414170N, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## **NENI 7. LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## **NENI 8. DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë duke autorizuar **Administratorin Z. Besnik Myftari** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

**ORTAKU THEMELUES**

**BESNIK MYFTARI**

